URDHËR
Nr. 618, datë 25.6.2025

PËR MARRJEN E MASAVE KUFIZUESE PËR PARANDALIMIN DHE KONTROLLIN E SËMUNDJES SË MURTAJËS SË RUMINANTËVE TË VEGJËL

Mbështetur në nenin 102, pika 4, të Kushtetutës, në shkronjën "b", të nenit 15, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e tregtimit të ruminantëve të vegjël në tregjet e kafshëve të gjalla, panaire dhe grumbullime të tjera.
2. Ndalimi i lëvizjes së ruminantëve të vegjël dhe specieve të tjera të mbarështuar në fermën e prekur nga sëmundja.
3. Intensifikimin e mbikëqyrjes së popullatave të ruminantëve të vegjël.
4. Forcimin e masave të biosigurisë.
5. Kafshët e llojit të imëta duhet të mbarështohen sipas kërkesave shëndetësore të mbarështimit të tyre, si dhe të jenë të izoluara nga kafshët e tjera në fermë dhe të kufizohet kontakti me kafshët e tjera.
6. Intensifikimin e fushatave të ndërgjegjësimit të fermerëve, transportuesve të kafshëve, veterinerëve privatë dhe shërbimit veterinar shtetëror.
7. Masat e sipërcituara nga pika 1 deri në pikën 6 zbatohen në territorin e:

Nr.	Rrethi	Njësia administrative	Fshati
3 km			
1	Korçë	Pirg	Novoselë
2	Korçë	Libonik	Këmbëthekër
3	Korçë	Libonik	Shkozë
4	Korçë	Libonik	Symiz
5	Korçë	Libonik	Zboq
6	Korçë	Pirg	Sovjan
10 km			
7	Korçë	Pirg	Kakaç
8	Korçë	Pirg	Shqitas
9	Korçë	Pirg	Leminot
10	Korçë	Pirg	Pirg
11	Korçë	Pirg	Gurishtë
12	Korçë	Pirg	Zvirinë
13	Korçë	Pirg	Veliternë
14	Pogradec	Çerrave	Pretushë
15	Pogradec	Çerrave	Nizhavec
16	Korçë	Vreshtas	Vreshtas
17	Korçë	Vreshtas	Sheqeras
18	Korçë	Pojan	Orman
19	Korçë	Pojan	Rembec
20	Korçë	Libonik	Drithas
21	Korçë	Libonik	Volçisht
22	Korçë	Libonik	Poçestë
23	Korçë	Libonik	Vashtemi
24	Korçë	Qendër Bulgarec	Lumalas
25	Korçë	Qendër Bulgarec	Biranj

26	Korçë	Bashkia Maliq	Maliq
27	Korçë	Bashkia Maliq	Fshat Maliq
28	Korçë	Bashkia Maliq	Kolanec
29	Korçë	Gorë	Damjanec
30	Korçë	Bashkia Maliq	Goce
31	Korçë	Bashkia Maliq	Bickë
32	Korçë	Bashkia Maliq	Gjyras
33	Korçë	Bashkia Maliq	Plovisht
34	Korçë	Gorë	Senisht
35	Korçë	Gorë	Dolan
36	Korçë	Gorë	Tresovë
37	Korçë	Gorë	Babjen
38	Korçë	Gorë	Qenckë
39	Korçë	Gorë	Moçan
40	Korçë	Gorë	Desmirë
41	Korçë	Libonik	Beras
42	Korçë	Libonik	Memel
43	Korçë	Gorë	Marjan
44	Korçë	Gorë	Dolanec
45	Korçë	Pirg	Qershizë
46	Korçë	Pirg	Mjaltas
47	Korçë	Libonik	Manastirnec
48	Pogradec	Dardhas	Grunjas

8. Intensifikimin e kontrollit veterinar në fermat që mbarështojnë ruminantë të vegjël dhe tregjet e kafshëve të gjalla në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

9. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj